



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-4361/24  
Kaçanik, 23.02.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23 shkurt 2024 Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës Besim Ilazi, Nënkryetari - Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Qamil Stagova – DUKMM, Ramadush Osmani –DSHPE, Bahri Selimi-DBF, Suhad Dullovi – DBZHRP, Pranvera Loku-Zharku – DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtëse: Mavije Murseli - Asistente e Kryesuesit të Kuvendit

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në këtë mbledhje janë 7 anëtarët- të gjithë. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 23 shkurt me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar – Dhjetor 2023;
4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2023/2024 ;
5. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023;
6. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;
7. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite;
8. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës;

9. Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite;

10. Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

#### **Aprovoj**

**Rendin e punës në përbërje prej 10 pikave.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

**z. Agim Mani:** Unë mendoj që ka qenë me rëndësi një fjala e imja Këmbimi i pronave kam thënë pronat që janë këmbje edhe pronat private edhe pronat komunale kanë dal në interes publik, pronat që konsiderohen që janë private janë me flete poseduese shoqërore.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri, me vërejtjen e Agim Manit. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

#### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 24.01.2023 / Lënda: 01Nr. 060/01-1913/24.**

Procesverbali do të publikohet i korigjuar.

2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, është voluminoz, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky raport ka qenë dashtë me qenë i harmonizuar me planin e ekzekutivit sepse fillimisht bëhet planit krahasim me punët e realizuara, kështu që në këtë raport janë përfshirë të gjitha drejtorit dhe secila nga drejtoritë ka dhënë raportin e tyre veç e veç. Me qëllim që të behet ky diskutim me interaktiv dëshirojë që në përgjithësi ti elaborojë drejtoritë, në mënyrë që pyetjet të cilat do ti shtrojë do të marrë përgjigjeje nga ta.

Tek Drejtoria e Gjendjes Civile thuhet se janë kryer 34.626 .

Te Drejtoria e Shëndetësisë janë kryer 346,630 shërbime, sa ka qenë inkasimi nga këto shërbime?

**Kryetari i Komunës:** Kemi marr një vendim në kuvendin komunal, me c ‘rast i kemi liruar deri në një vendim tjetër, deri te përfundimi të gjendjes së pandemisë.

**z. Agim Mani:** Me sa kam njohuri unë, ky vendimi është marrë vetëm në kohën e pandemisë!

**znj. Ardita Rrahmani:** I nderuar Kryetar, ne e kemi diskutuar edhe para dy seancave që ka përfundua, por thjesht jemi vonuar ne, sepse pandemia është shpallur e mbyllur edhe qeveria e Kosovës qysh në muajin maj e ka përcjell vendimin që ka shpall pandeminë të mbyllur në Kosovë gjithashtu me 5 maj është shpallur edhe nga OBSH-ja.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sido që të jetë përfundoj apo nuk përfundoj, pa një Vendim të rij të Kuvendit ajo mbetet në fuqi.

**z. Agim Mani** Sa i përket shërbimeve sociale kjo ka ndikuar pozitivisht pasi që ka shkuar në rëmje te asistenca sociale.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, ujësjellësi që kam parë fazën e dytë Ivajë 6 km, kjo nënkupton që ky fshat më herët nuk ka pas ujësjellës d.m.th. nuk u kanë i sistemuar me ujësjellës edhe faza tret parashihet një investim i madh ndërsa faza parë ka përfunduar. Sa i përket ndriçimit publik, është investuar në 5143 metra me 158 fshatra. Tek ndriçimi publik i keni pasur dy kontrata për mirëmbajtje dhe që të dyja kanë qenë nga 6 mijë e diçka euro, ku njëra ka qenë për mirëmbajtje dhe njëra dhe për dekorim, andaj në këtë rast më intereson pse nuk e keni mirëmbajtje mbase e keni marrë buxhetin apo nuk ju ka mjaftuar ky buxhet.

Drejtoria e Bujqësisë është angazhuar me qytetar për kompletimin e dokumentacionit lidhur me subvencionet që kanë përfituar.

Në këtë rast i drejtohem me një pyetje Drejtorit të Bujqësisë, sa metra katror të bujqësisë i keni këmbyer dhe i keni shndërruar në tokë ndërtimore?

Lidhur me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, po e vërej që drejtoresha nuk është këtu prezentë mirëpo theksojë që ajo më shumë nuk ka paraqit raport por ka paraqitur kompetencat e veta që i ka andaj nuk mund ta quajmë raport që është i saj. Raporti ka mangësi të mëdha pasi që i ka përfshi disa data që nuk janë në planifikim dhe as në realizim.

Te Drejtoria Urbanizmit, gjatë tërë vitit kam kërkuar vazhdimisht te kontratat urbane dhe lokale tek asfaltimi i rrugëve që para se me dal tenderi ose kur tenderohen, ta dimë cilat rrugë kanë me u shtrua mirëpo nuk kam marr asnjëherë përgjigje, krejt tani në fund i keni paraqitur emrat se cilat rrugë i keni me i shtrua me asfalt dhe cilat janë përfunduar. Për transparencë këtë e kam kërkuar pasi që kam qenë në dijeni që këto projekte do të zhvillohni ka të dëshironi ju konkretisht nga militantët e PDK-së, dhe këtë po e them prej fakteve të miya sepse është shtrua një rrugë me 50 metra dhe nuk është shtruar rruga tjetër me 300 metra, kjo ka qenë arsyeja që unë vazhdimisht kam kërkuar këtë përgjigjeje e cila asnjëherë nuk me është dhënë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti është vjetor dhe nuk ka mundur me u harmonizua me planifikimin që kemi bërë tani, sepse ky planifikim është bërë për këtë vit nuk është bërë për vitin e kaluar.

Ky raport duhet me qenë në harmoni me planin e vitit të kaluar që është bërë dhe që kemi votuar tash një vit me qellim që të shihet se sa janë përmbushur objektivat dhe synimet e ekzekutivit që i kanë paraqitur në plan atëherë me raportin e punës që e kanë e sjellë sot.

**Agim Mani :** Jo Kryesues unë nuk e përmenda planifikimin e këtij viti, unë e kam lexuar edhe planifikimin e vitit kaluar kështu që unë jam bazuar në planifikimin e vitit kaluar dhe raportin.

**znj.Dardana Tafili Dauti :** Agimi pyeti për numrin e certifikatave që i ka lëshuar Gjendja Civile është 34.626, realisht Agim nuk e di a jeni bazuar në raportin financiar apo në raportin intranetit, por tani do të ta jap përgjigjeje, pasi që edhe unë kam qenë kureshtare ta dijë, pse është një numër kaq i madh i certifikatave ku realisht edhe me raport financiar kemi vlerën 28.725, edhe në raportin intranetit na kanë gjeneru të dhënat prej sistemit ku raporti i përgjithshëm i të gjitha lendeve është 33.508, mirëpo nga informacioni zyrtar që e kam marr prej agjensionit të regjistrimit civil, është se këto certifikata na gjenerohen përmes sistemit ku përgatitet raporti, se çdo hapje që bëhet dhe me shikua një certifikatë nga zyrtari konsiderohet si e lëshuar. Çdo verifikim të cilin e bëjmë për polici, gjykatat, ambasadat, penzionerat dhe kush do që kërkon prej komunës tonë me ditë se kush është ky person edhe që ne në sistem i hapim dhe ua dërgojmë ata konsiderohen si të kryera.

**z. Ramadush Osmani:** Për çështjen e ujësjellësit në fshatin Ivajë, është e vërtet që nuk ka pasur rrjet të përbashkët Ivaja. Ne kemi punuar në bazë të projektit ashtu si e ka dorëzuar komuniteti. Në vitin 2023 ne e kemi zgjidhjen e rrjetit primar por është edhe rrjeti sekondar që do të kryhet gradualisht.

Te ndriçimi publik nuk kemi kontratë 3 vjeçare që e kam kërkuar zakonisht mirëmbajtje të vazhdueshme, për shkak të ankesave të vazhdueshme prej shtatorit të vitit 2022 dhe ende kemi ankesa për këtë kontratë. Unë si drejtori duke e parë emergjencën dhe kërkesat e qytetareve dhe me verifikimin që e kam bërë jam detyruar me qite kontrata emergjente nën 10.000 euro, e kam shpenzuar njërën dhe kam intervenuar aty ku janë më emergjente. Për informimin tuaj, kemi 85 rrjete të ndriçimit publik ku afërsisht janë 2600 trupa ndriçues të cilët kanë një jetë gjatësi dhe gradualisht vijjnë duke u shpenzuar dhe duke u dobësuar, kështu që e kam hargjuar atë kontratë dhe kam pritur që mos po lidhet kontrata por për shkak të ankesave përsëri jam detyruar edhe një kontratë tjetër për me ndërhy në rrjetet ekzistuese, këto kanë qenë kontrata për mirëmbajtje emergjente ndërsa se ai për këtë dekorimit ka qenë një kontratë tjetër e cila është bërë për fund vit dhe nuk është me ndriçim publik .

**z. Qamil Stagova:** Në raport janë paraqitur rrugët të cilat janë rregulluar dhe asfaltuar, por jashtë raportit po qëndron fjala Agimit d.m.th. që ne nuk e kemi poseduar listën e këtyre rrugëve.

**z. Agim Mani:** Drejtor, paraprakisht kur është dhënë tenderi, ju si drejtori a keni qenë në dijeni fillimisht se cilat rrugë keni me i shtrua, apo nuk e keni ditur as ju, pasi që nuk po me jepni një përgjigjeje të saktë lidhur me këtë.

**z. Qamil Stagova:** Raporti me që është raport këto që janë kryer janë raport.

**Kryesuesi i Kuventit:** Te rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale është ndërhy edhe në rastet kur ka pasur shembje, dëmtime të rrugëve, sa i përket targetit të militantizmit urojë që në atë rrugë keni dhe ju ndonjë militant, pasi që nëse nuk e kishit pasur atë rrugë nuk e di se si kishit ardhur deri këtu.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Unë deshta me u ndërlidh te inspektorati i komunës, pasi që lumi Nerodime ka devijuar në fshatin Runjevë dhe ka hyrë në toka private, arsyeja e shembjeve të dheut nga lart mbushjet që nuk e di se inspektorati a i ka vërejtur dhe tani i gjithë lumi ka devijua në toka private të personave andaj qytetaret e këtij fshati kanë paraqitur kërkesën dhe kanë vendosur me formua një komision dhe me dalë në vendin e ngjarjes. Për Drejtorin e Shërbimeve Publike dua të pyes lidhur me parkingjet tek rruga Qamil Ilazi, projektin që e keni parapa veç se ka dështuar qysh në fillim i cili ka qenë i mirë për disa biznese por për disa jo, lidhur me këtë rast e keni pasur edhe një operator Vlora në kuadër që e ka fituar tenderin, nëse kishit pasur mundësi me na i sqarua si i keni pasur kushtet përderisa se veç tre muaj ka funksionuar raporti biznesit në atë kompani dhe sa biznese kanë paguar parkingje në atë pjese apo sa individ që kanë bërë pagesa mujore?

**z. Ramadush Osmani:** Çështja e rrugës “Qamil Ilazi”, ka qenë shumë diskutabile te parkingjet se jo rrjedha e trafikut. Ideja ka qenë të krijohen vend parkingje mirëpo bizneset kanë qenë të parët ata që kanë kundërshtuar me arsyetimin që ju nuk po na lejoni të kryem shërbime, kështu që ne kemi formuar një komision, që në fakt e cekët edhe ju pjesën e menaxhimit të tyre duke e parë që njerëzit po i lejnë nga 24 orë dhe ne jemi detyruar me mirëmbajtje me pagesë, gjithashtu citojë që u lajmërua një kompani e cila e mbajti dy muaj dhe fatkeqësisht nuk shpreh gatishmëri të vazhdojë sepse nuk kishte fitim, andaj ne e formuam një komision prej zyrës së Kryetarit me qëllim që të analizohet gjendja e krijuar pas rrjedhës së trafikut dhe krijimeve të vend parkingjeve dhe reagimeve që i keni adresuar në kuvend. Ky komision ka bërë një rekomandim i cili i është dorëzuar Kryetarit me sugjerime se si të veprohet dhe tani me Vendim të Kryetarit nuk ka parkingje por me funksionu, me qëllim që mos me bihet në kundërshtim sinjalizimi horizontal me atë vertikal sepse najë kanë qitur ndalohet e kemi detyrua kompaninë në kushte jo te mira me i fshij dhe ajo nuk ka funksionu mirë për shkak se ka qenë kohë e ngrirë dhe si të krijohen kushtet do ti fshijmë rruga do të jetë njëkaheshe pa parkingje por

rrjedhimisht bienë në kundërshtim sepse shihet e vizatime por e kemi njoftuar edhe policinë që të kenë konsideratë që të mos dënohen qytetarët .

**znj. Kadrije Lika Troni:** A keni bërë njoftimin lidhur me këtë rrugë, sepse unë nuk kam parë që keni bërë njoftim në ueb faqe të komunës me qëllim të informimit të qytetarëve të komunës me çështjen e lartë cekur?

**z. Ramadush Osmani:** E kemi njoftuar policinë dhe shenjat janë dhe ne do të intervenojmë në rifshirjen e atyre.

**z. Agim Mani:** Pyetjen që e shtroi znj. Kadrije, unë nënkuptova që pyetja ishte se sa ka inkasua kompania.

**z. Ramadush Osmani:** Kompania ndaj komunës e ka kryer obligimin e saj, i ka pasur 33 parkingje në vlerën prej 10.50 cent në muaj .Te ne si komunë e ka kryer këstin sipas procedurave, por a ka fituar apo nuk ka fituar nuk me intereson ajo pjesë dhe ne si komunë i kemi inkasuar prej kompanisë, mirëpo ajo e ka parë që nuk po mbulohet dhe është në marrëveshje që mund të paralajmëron 15 ditë para, nëse nuk dëshiron të vazhdojë në muajt e tjerë.

**z. Agim Mani:** Parkingu te shtëpia e mallrave deri te xhamia, mendoj që duhet të hiqet largohet menjëherë, nuk e di nëse e keni vërejtur që kamionët e mëdhenj po hasin në vështirësi të mëdha gjersa po kthehen tek rrethi.

**z. Ramadush Osmani:** Nuk është problemi i vend parkingut që ne e kemi shenjzuar por është problemi tek qytetarët të cilët parkohen para vend parkingut mirëpo ajo kjo çështje është ne kompetencë të institucionit të policisë.

**z. Agim Mani:** Ju ja keni mundësuar me shenjë aty qytetarit, prandaj nuk mund të dënohet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Problemi më i madh nuk qëndron te shtëpia mallrave, por problemi është tek marketi ku gjatë gjithë kohës ka ngarkesa- shkarkesa, pra aty krijohen pengesat më të mëdha për me kalua në atë pjesë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nëse mundem edhe diçka tjetër që me i paraprije edhe seancës Kuvendit ka të bëjë me Planin zhvillimorë komunal kisha kërkua nga drejtori që atë ditë që të paktën të mos pritem një muaj të marrim një përgjigje veç për një arsye duhet ta keni parasysh që fillimi i regjistrimit të popullsisë është në muajin prill, ndërsa plani zhvillimor i komunës se Kaçanikut është 2 vite me vonesë dhe ne ende nuk jemi as afër kohës as për miratimin e tij para muajit prill, kjo i paraprinë rrezikut të rënies së numrit të popullsisë së komunës së Kaçanikut, i cili numër do të bie nën 30,000.00. Në momentin që bien numri i popullsisë atëherë etazhiteti i popullsisë bien edhe etazhiteti i ndërtimit bien andaj në këtë rast, asnjë investitor nuk ka llogari ta merr token dhe të ndërtojë vetëm 5 kat, kjo nënkupton që në 8 vitet e ardhshme do të ulet numri i banorëve, nr. etazhitetit, gjithashtu edhe numri i asamblistëve sepse si alternative do ta shohin qytetin e Ferizajt, kështu do të zvogëlohet edhe buxheti i komunës sonë. Prandaj ju lutem të na njoftoni se çka është duke u vepruar drejt planit zhvillimor komunal duke pas parasysh që janë bllokuar edhe ndërtimet e reja, të gjitha këto paraqesin rrezik dhe është duke u alarmua krejt popullata për këtë pasi që do të ketë pasoja largimi i popullsisë nga Kaçaniku.

**z. Qamil Stagova:** Nëse jeni të pajtimit, në mbledhjen e ardhshme do ta përgatisim një informatë lidhur me këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk kam njohuri rreth asaj se si do të zhvillohet procesi i regjistrimit, , a do të përfshihen vetëm banorët rezident apo edhe banorët jo rezident. Nëse përfshihen

